



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 527 prot.
18

Tiranë, më 21.10.2022

VENDIM

Nr. 915, Datë 21.10.2022

“**MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË VGP HOLDINGS LLC NGA SHOQËRIA ARAMCO OVERSEAS COMPANY B.V., NËPËRMJET SHOQËRISË GATEWAY VELOCITY HOLDING CORP**”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.10.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë VGP Holdings LLC nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V., nëpërmjet shoqërisë Gateway Velocity Holding Corp.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë VGP Holdings LLC nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V., nëpërmjet shoqërisë Gateway Velocity Holding Corp.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë VGP Holdings LLC nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V., nëpërmjet shoqërisë Gateway Velocity Holding Corp.

Referuar Marrëveshjes, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Gateway Velocity Holding Corp., është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të shtetit Delaware, e themeluar për qëllime të caktuara, e angazhuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në çdo akt apo aktivitet të ligjshëm për të cilin mund të organizohen korporatat sipas Ligjit për Korporatat të Shtetit të Delaware.

Aramco Overseas Company B.V., shoqëria mëmë e shoqërisë Gateway Velocity Holding Corp, është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, me objekt veprimtarie: Dizajnim teknik dhe konsulencë inxhinierike etj., shoqëri holding (jo-financiare) dhe shoqëri pjesëmarrëse.

Sipas Marrëveshjes së lidhur, Aramco Overseas Company B.V. do të jetë një garantues materiale për shitësin, e cila i garanton shitësit në mënyrë absolute, të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme, si detyrim kryesor dhe jo thjesht si garanci, pagesën dhe përmbushjen e duhur dhe në kohë të të gjitha detyrimeve të blerësit.

Aramco Overseas Company B.V, zotërohet plotësisht nga ortaku i vetëm Saudi Arabian Oil Company, një shoqëri aksionare e themeluar nëpërmjet Dekretit Mbretëror nr. M/8 i Arabisë Saudite me objekt aktiviteti: Shoqëri e angazhuar kryesisht në kërkimin, eksplorimin, shpimin dhe nxjerrjen e substancave hidrokarbure dhe përpunimin, prodhimin, rafinimin dhe tregtimin e këtyre substancave.

Saudi Arabian Oil Company nuk ka prezencë ligjore të regjistruar në Shqipëri, por gjeneron të ardhura përmes tregtimit dhe shitjes së hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate.

Pala shitëse: Valvoline Inc., është një shoqëri, e themeluar, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe është një prodhues dhe distributor amerikan i vajit të automobilave, aditivëve dhe lubrifikantëve të markës Valvoline. Ajo zotëron gjithashtu zinxhirët Valvoline Instant Oil Change dhe Valvoline Express Care të qendrave të riparimit të makinave.

Shoqëria Valvoline Inc., është në proces riorganizimi përpara implementimit të transaksionit dhe si rrjedhojë Biznesi i Produkteve Globale do të zotërohet nga shoqëria VGP Holdings LLC.

Shoqëria Target: Valvoline Global Products (VGP) Holdings LLC, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar sipas legjislacionit të shtetit Delaware. Shoqëria është themeluar, si një shoqëri holding për të realizuar marrëveshjen për blerje kapitali, për të zotëruar drejtpërdrejtë ose tërthorazi, menjëherë para mbylljes dhe në vijim pas përfundimit të riorganizimit para mbylljes së marrëveshjes, degët e grupit dhe për rrjedhojë Biznesin që do transferohet.

Shoqëria target nuk ka degë të regjistruara në Shqipëri, por ajo përmes degës së saj në Serbi, (Ellis Enterprises East doo Krusevac), shet kryesisht produkte lubrifikante dhe ftohës në Shqipëri, nëpërmjet një distributori vendas (Autopasion SHA).

II. Përqendrimi

Më datë 31.07.2022, është lidhur “Marrëveshje për blerje kapitali”, ndërmjet shoqërisë Valvoline Inc., shoqërisë Gateway Velocity Holding Corp, dhe vetëm për qëllime të përcaktuara në seksionin 9.14 dhe seksionin 9.15, me shoqërinë Aramco Overseas Company B.V.

Qëllimi i marrëveshjes është shitja e kapitalit të shoqërisë VGP Holdings LLC, e cila përfshin Biznesin e Produkteve Globale të markës Valvoline.

Referuar marrëveshjes së mësipërme, blerësi dëshiron të blejë Interesat e Kapitalit të Transferuar nga shitësi, dhe shitësi dëshiron të shesë (ose të sigurohet që Dega e Shitësit të shesë) Interesat e Kapitalit të Transferuar te blerësi, në zbatim të termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshje. Mbas mbylljes shitësi (ose dega e shitësit) do të shesë, transferojë dhe dorëzojë te blerësi, dhe blerësi do të blejë dhe pranojë nga shitësi (ose dega e shitësit) Interesat e Kapitalit të Transferuar të lira nga çdo barrë.

Blerja dhe shitja e Interesave të Kapitalit të Transferuar, është parashikuar të realizohet nëpërmjet kësaj Marrëveshje dhe marrëveshjeve të tjera të transaksionit që do të referohen si transaksionet.

Në përfundim të kësaj marrëveshje, shoqëria Valvoline Inc., do të vazhdojë të zotërojë Biznesin e Shërbimeve me Pakicë (retail services), pa Kinën dhe disa vende në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut – ndërsa Aramco nëpërmjet shoqërisë Gateway Velocity Holding Corp, do të zotërojë markën Valvoline për të gjitha përdorimet e Produkteve në nivel Global (global products).

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shitjes me shumicë të lubrifikantëve dhe produkteve ftohëse, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e 100% të kapitalit të shoqërisë VGP Holdings LLC nga shoqëria Gateway Velocity Holding Corp. dhe përfitim të kontrollit indirekt nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V.

Shoqëria Aramco Overseas Company B.V. zotërohet tërësisht nga Saudi Arabian Oil Company, e cila nuk ka ndonjë filial të regjistruar në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet tregtimit dhe shitjes së hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate.

VGP Holding LLC, një shoqëri e krijuar posaçërisht për qëllimin e marrjes së një prej segmenteve të biznesit të Valvoline (Biznesi i Produkteve Globale), gjatë procesit të riorganizimit të shoqërisë përpara mbylljes së transaksionit. VGP Holding LLC. nuk ka degë të regjistruar në Shqipëri por realizon të ardhura nëpërmjet shitjes së produkteve lubrifikante dhe ftohëse, nëpërmjet një distributori të autorizuar vendas.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë VGP Holdings LLC nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V., nëpërmjet shoqërisë Gateway Velocity Holding Corp.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA




Zv/Kryetar

Rezana KONOMI



Anëtar

Adriana BERBERI



Anëtar

Durim KRAJA



Anëtar

